



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.12, 1.17 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 360 paragrafi 1, 2 dhe 3 i Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, në mbledhjen e 218-të, të mbajtur me datë 27 maj 2019, mori këtë:

V E N D I M

- I. Anëtarë të Komisionit Profesional për Vlerësimin e Përmbartimit propozohen gjyqtarët si në vijim:
 1. Znj. Edije Sezairi- gjyqtare, Gjykata Themelore në Prizren;
 2. Znj. Naime Ahmeti- gjyqtare, Gjykata Themelore në Prishtinë;
 3. Z. Lumni Sallauka- gjyqtar, Gjykata e Apelit;
 4. Z. Shukri Sylejmani- gjyqtar, Gjykata Supreme, si dhe
 5. Znj. Manushe Karaqi- Anëtare e KGJK-së;

- II. Zëvendës Anëtarë të Komisionit Profesional për Vlerësimin e Përmbartimit propozohen gjyqtarët si në vijim:
 1. Z. Alajdin Tërshnjaku- gjyqtar, Gjykata Themelore në Prishtinë;
 2. Z. Arton Fazliu- gjyqtar, Gjykata Themelore në Prishtinë;
 3. Z. Valon Totaj- gjyqtar, Gjykata e Apelit;
 4. Z. Beshir Islami- gjyqtar, Gjykata Supreme, si dhe
 5. Z. Nehat Idrizi- Anëtar i KGJK-së;

- III. Anëtarët dhe Zëvendës Anëtarët e Komisionit Profesional për Vlerësimin e Përmbartimit emërohen për periudhën prej katër (4) vitesh.

- IV. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 maj 2019.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyësor i Kosovës, me datë 16 prill 2019, ka pranuar nje Kërkesë nga znj. Fadilete Hoxhaj-Blakçori, Udhëheqëse e Divizionit për Noterinë dhe Përmbartimin Privat-Departamenti i Profesioneve të Lira në Ministrinë e Drejtësisë, përmes së cilës e njëjta ka njoftuar se Komisionit Profesional për Vlerësimin e Përmbartimit i emëruar me Vendim të Ministrit të Drejtësisë i

përfundon mandati me 21 maj 2019. Me ç'rast nga KGJK kërkohet që duke u bazuar në nenin 360 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore të propozoj dy (2) anëtarë dhe zëvendës anëtar nga Gjykata Themelore, një (1) anëtar dhe një (1) zëvendës anëtarë nga Gjykata e Apelit, një (1) anëtarë dhe një (1) zëvendës anëtarë nga Gjykata Supreme, si dhe nga Këshilli Gjyqësor i Kosovë një (1) anëtarë dhe një (1) zëvendës anëtar, të cilët me pas emërohen nga Ministri i Drejtësisë për periudhën prej katër (4) vitesh.

KGJK, pas shqyritimit të kërkesës së znj. Hoxhaj-Blakçori, në mbështetje të nenit 360 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Skenderi COÇAJ,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- *Të gjithë Anëtarëve dhe Zëvendës Anëtarëve të propozuar për Komisionin Profesional për Vlerësimin e Përmbartimit;*
- *Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë;*
- *Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren;*
- *Kryetarit të Gjykatës së Apelit;*
- *Kryetarit të Gjykatës Supreme;*
- *Ministrisë së Drejtësisë- Departamentit të Profesioneve të Lira;*
- *Departamentit të Administratës së Përgjithshme të SKGJK-së;*
- *Arkivit.*